



This project is funded by
the European Union



*Empowered lives.
Resilient nations.*



Pyetje të shpeshta mbi Thirrjet e Hapura nga 12 Bashki partnere të projektit ReLOAD në Shqipëri.



This project is funded by
the European Union



Empowered lives.
Resilient nations.

1. Si do të paraqitet Buxheti në aplikim?

Shtojca 8 është buxheti i projektit. Në rreshtin e parë, duhen vendosur muajt që ju parashikoni për zbatimin e projektit dhe me pas vlera totale për çdo aktivitet. Kjo Shtojcë sugjerohet të shoqërohet edhe me një dokument ku detajohet kosto për çdo aktivitet (Aktiviteti 1: sasia x çmimi = vlera totale).

2. Në Udhëzim thuhet se organizatat mund të dorëzojnë më shumë se një projekt nëse shuma totale nuk kalon 8.000.000 lek. Mund të shkruajmë një projekt të ndarë në dy faza me buxhet më vete, apo duhet shkruar për çdo vit një projekt më vete?

Ju mund të propozoni më shumë se një projekt, vlera totale e të cilëve nuk e kalon shumën 8.000.000 lek.

3. Kush e certifikon raportin financiar?

Raporti financiar i referohet raportit që organizatat dorëzojnë në institucionet tatimore për vitin paraardhës.

4. A mund të aplikojë një media ?

Thirrja është e hapur vetëm për organizatat e shoqërisë civile të regjistruara sipas legjislacionit në Shqipëri.

5. Çfarë është raporti narrativ?

Raporti narrativ i referohet një raporti të aktiviteteve që organizatat ky kryer gjatë vitit paraardhës.

6. Duke qenë se ne aktualisht kemi projekte në vazhdim me UNDP që mbaron në Qershor 2018, a është e mundur që të aplikojmë për Thirrjen e hapur?

Po, nëse keni kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe financiare për zbatimin në kohë të projektit.

7. A mund të aplikojë Kryqi i Kuq Shqiptar për të përfituar projekte nga kjo Thirrje?

Kryqi i Kuq mund të aplikojë si të gjitha organizatat e tjera të shoqërisë civile.

8. A është Thirrja e hapur për të gjitha organizatat e shoqërisë civile apo vetëm për ato organizata që kanë veprimtari në 12 bashkitë partnere?



This project is funded by
the European Union



Empowered lives.
Resilient nations.

Thirrja është e hapur për të gjitha organizatat e shoqërisë civile të regjistruara sipas legjislacionit në Shqipëri.

9. A mund të aplikohet si konsorcium në formatin OSHC + institucion arsimit të lartë publik/jopublik?

Mund të aplikohet në partneritet, i cili mund të krijohet vetëm ndërmjet organizatave të shoqërisë civile. Institucionet publike mund të jenë bashkëpunëtorë të projektit, por nuk do të përfitojnë fonde për zbatimin e tij.

10. Në Shtojcën 7: Informacion mbi organizatën që aplikon, duhet informacion vetëm brenda tabelës apo të edhe të dhëna më të detajuara?

Përveç të dhënave në tabelë, ju lutem paraqisni edhe një përshkrim të shkurtër të historisë së organizatës, misionin, vizionin dhe strategjitë kryesore të saj.

11. Sa është kohëzgjatja e një projekti?

Kohëzgjatja e projektit varion nga 6-12 muaj.

12. A do të ketë bashkëfinancim nga organizatat?

Jo. Ky është një grant, i cili nuk përfshin bashkëfinancim nga organizata.

13. Çfarë nënkuptoni me dokumente të tjera relevante?

Dokumente relevante janë të gjithë ato dokumente që ju mendoni se i shtojnë vlerë propozimit tuaj. Psh një memorandum bashkëpunimi që mund të keni me organizata të tjera partnere apo me institucione shtetërore.

14. Si duhet të jetë deklarata e partneritetit?

Nuk ka një format për deklaratën e partneritetit. Përgatitet nga vetë partnerët, të cilët angazhohen për të zbatuar bashkë projektin dhe specifikojnë aktivitetet që do të kryejë secila sipas planit të veprimit. Partnerët firmosin deklaratën.



This project is funded by
the European Union



*Empowered lives.
Resilient nations.*

15. Kur meren përgjigjet për aplikimin?

Rezultatet (pavarësisht nëse jeni ose fitues) do të bëhen publike brenda 30 ditëve pune nga afati i mbylljes së Thirrjes.

16. I am a person with a disability and therefore I use a voice program for the computer which works only in English. My question is can I complete the application using English language instead of Albanian?

Considering your needs, the application in English will be considered at this stage. Please, be informed that this is an exception only for people with specific needs.